

UDHËZIM
Nr.17, datë 10.10.2003

PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË ME VENDIM GJYKATE

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 100 pika 6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e procedurës së votimit të zgjedhësve që nuk janë regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve dhe paraqiten në qendrën e votimit me një vendim gjykatë që i jep të drejtën për të votuar.

Neni 2

Zgjedhësit që nuk janë regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve lejohen të votojnë kur paraqesin një vendim gjykatë që u jep të drejtën të votojnë në atë qendër votimi.

Neni 3

a) Pas hyrjes në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një prej dokumenteve të mëposhtme:

1. certifikatë me fotografi,
2. letërnjoftim,
3. pasaportë.

b) Zgjedhësi paraqet para komisionit të qendrës së votimit vendimin e gjykatës që i jep të drejtën për të votuar në QV.

c) Komisioni i QV-së verifikon paraprakisht, nëse emri i zgjedhësit figuron në listën përfundimtare të zgjedhësve të QV-së.

d) Në rast se nga verifikimi rezulton se emri i zgjedhësit nuk figuron në listën e zgjedhësve, ai e regjistron atë në një regjistër të veçantë.

e) Zgjedhësi nënshkruan në regjistrin e veçantë përkrah emrit të tij.

ë) Vendimi i gjykatës ruhet prej KQV-së.

Neni 4

Pas mbarimit të procedurës së mësipërme, zgjedhësit i jepet fleta e votimit dhe lejohet të votojë.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.